



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.954/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Zyhdi Haziri, kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me apelin e Adrian Çoçës kandidat për kuvendin komunal në Prishtinë nga subjekti politik Alternativa dega në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli i Adrian Çoçës kandidat për kuvendin komunal në Prishtinë nga subjekti politik Alternativa dega në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet e kandidatëve për anëtarë të Kuvendit Komunal në Prishtinë nga subjekti politik Alternativa dega në Prishtinë për vendvotimet: 1906E/01R; 1906E/02R; 1906E/03R

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutit e Vendvotimeve si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një apel më datë 10.11.2017 në ora 11:30 nga Adrian Çoça kandidat për kuvendin komunal në Prishtinë nga subjekti politik Alternativa dega në Prishtinë në të cilin pretendon se ka munges të votave nga vendvotimet 1906E/01R; 1906E/02R; 1906E/03R.

Parashtruesi i apelit kërkon nga PZAP-i që ky apel të pranohet si i bazuar dhe ti urdhërohet KQZ-së që të vërtetojë gjendjen e saktë faktike

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor dhe pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për anëtarë të Kuvendit Komunal në Prishtinë nga subjekti politik Alternativa dega në Prishtinë, për vendvotimet e lartcekura, ashtu që rezultati i dal nga ky rinumërim ti bashkëngjitet rezultatit përfundimtar.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL A nr. 954/2017 më datën 12.11.2017.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.